

Tiranë më 01.06.2022

## SHOQATA E KONVERTUESVE TË PLASTIKËS SË SHQIPËRISË

### DEKLARATË PËR MEDIAT

Dëshirojmë të informojmë publikun, konsumatorët dhe klientët tanë për ndryshimet ligjore që kanë hyrë në fuqi më dt.01.06.2022 në lidhje me **prodhimin, importimin dhe hedhjen në treg** të qeseve plastike në Republikën e Shqipërisë.

Me gjithë vërejtjet tona për anekse të ndryshme të draftit, tashmë që ligji ka hyrë në fuqi, ne jemi në anën e tij dhe do të nxisin zbatimin nga të gjithë, subjekte dhe qytetarë.

Ne si prodhues të ambalazheve plastike jemi të vetëdijshëm se zbatimi me korrektësi dhe efikasitet i këtyre ndryshimeve ligjore do të kontribuojnë pozitivisht në ruajtjen dhe garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik në raport me mjedisin.

Referuar ndryshimeve ligjore që ju bënë ligjit **Nr.10463** dt.22.09.2011 me ligjin **Nr.28** dt.17.03.2022 dhe VKM **Nr.367** dt.30.5.2022 e dalë në zbatim të këtyre ndryshimeve për ndalimin e "**QESEVE PLASTIKE NJËPËRDORIMSHE**" në vendin tonë ju informojmë se:

Nga data 01.06.2022 në vendin tonë do të jetë e ndaluar të **importohen, prodhohen dhe hidhen në treg "QESËT PLASTIKE NJËPËRDORIMSHE"**.

Do të jenë të lejuara, të prodhohen, importohen dhe hidhen në tregun e Republikës së Shqipërisë "**QESËT PLASTIKE SHUMËPËRDORIMSHE**", të cilat duhet të plotësojnë këto kritere dhe standarte, teknike e mjedisore:

1-**GJATËSIA** e plotë e qeses e lejuar duhet të jetë jo më pak se **50 cm**.

2-**GJERËSIA** më e vogël e lejuar e qeses duhet të jetë jo më pak se **24 cm**.

(Pa përfshire palosjet anësore të qeses)

3-**TRASHËSIA** e qeses plastike do të duhet të jetë jo më pak se **70 Micron** për anë.

4-"**QESËT PLASTIKE SHUMËPËRDORIMSHE**" nuk duhet të kenë në përbërje aditive oxo-degradues apo oxo-biodegradues.

5-"**QESËT PLASTIKE SHUMËPËRDORIMSHE**" do të duhet të kenë të stampuar "vulën" e gjurmueshmërisë së prodhuesit, apo importuesit në vendin tonë.



Në të gjitha rastet kur nga operatorët ekonomikë në vendin tonë **do të importohen, prodhohen dhe hidhen ne treg** qese plastike që nuk përmbushin të gjitha kriteret dhe standartet e sipër cituara do të zbatohen gjoba dhe penalitete si më poshtë vijon:

**-Personi fizik/juridik që importon, prodhon, hedh në treg "QESE PLASTIKE NJËPËRDORIMSHE" gjobitet në masën 500.000 lekë dhe i sekuestrohet e gjithë sasia e qeseve plastike të ndaluara që posedon.**

**-Në rast përsëritjeje, gjoba vendoset në vlerën 1.500.000 lekë dhe me sekuestrim të gjithë sasisë së qeseve plastike të ndaluara.**

**-Në rastet e përsëritjes edhe pas gjobitjes në vlerën 1.500.000 lekë dhe me sekuestrim të plotë të qeseve plastike të ndaluara, operatori ekonomik dënohet me revokimin e lejes/licensës së prodhimit dhe sekuestrimin e të gjitha qeseve plastike të ndaluara që posedon.**

**Shoqata e Konveruesve të Plastikës** është e gatshme të kontribuojë me informim të publikut apo edhe operatorëve ekonomikë që janë të interesuar për më shumë informacione dhe detaje teknike në lidhje me këtë proces.

Ne do të nxisim vazhdimisht zbatimin e ligjit dhe do të kontribuojmë në denoncimin, nëse do të konstatojmë raste kur në treg mund të depërtojnë qese të ndaluara, që futen në rrugë të paligjshme.

**Tel.: +355 42 40 7777**

**E-mail: [info@apka.al](mailto:info@apka.al)**

**Adresa: Rr.17 Nëntori, Kashar, Tiranë**

**Website: [www.apka.al](http://www.apka.al)**

**Facebook: Shoqata Apka**